



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.309/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevcu kryesuese, Faton Ademi dhe Ferki Xhaferi anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarës së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesat e Koalicionit AAK-PSD, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të Thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, për për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 06 tetor 2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.10.2019, mori këtë:

#### V E N D I M

**HUDHEN** të pa rregullta: ankesat Anr. 309/2019, Anr 310/2019 dhe Anr 311/2019 e datës 06.10.2019 të parashtruara nga koalicioni AAK-PSD, me seli në Prishtinë, e parashtruar kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje.

#### A r s y e t i m

Me datën 06.10.2019, PZAP-i ka pranuar ankesat Anr.309/2019, Anr.310/2019 dhe Anr. 311/2019 të parashtruara nga koalicioni AAK-PSD, me të cilën ka pretenduar se Levizja Vetëvendosje (LVV) ka bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore, duke shpërndarë video dhe fotografi me spote publicitare të subjektit të tyre politik. Parashtruesi i ankesës pretendon se subjekti politik LVV ka bërë shkeljen e rregullave zgjedhore. Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur fotografi në lidhje me rastin në fjalë.

Paneli, paraprakisht ka vlerësuar se ankesat: Anr.309/2019, Anr. 310/2019 dhe Anr.311/2019, të gjitha të datës 06.10.2019, janë për nga përmbajtja të njëjta, për nga natyra e shkeljes së pretenduar janë të njëjta, janë paraqitur nga e njëjta palë ankuuese kundër subjektit të njëjtë politik, prandaj paneli bazuar në nenin 8 paragrafi 3 i Rregullave dhe Procedurave Nr.02/2015, të PZAP-it, në të cilën përcaktohet se: *Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave kryesuesi i panelit vend marrës mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato ankesa të trajtohen me një vendim*”, andaj paneli bëri bashkimin e ankesave dhe për të njëjtat vendosi me një vendim, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankeses gjeti se:

**Ankesat janë të pa rregullta**

Paneli, nga shkresat e lëndës vlerësoj se ankesat e parashtruara nga ana koalicioni AAK-PSD janë të parregullta, sepse ankesat në fjalë nuk janë nënshkruar nga parashtruesi i ankesave dhe si tilla ankesat nuk i plotësojnë kërkesat ashtu siç parashihet me nenin 5.6 të Rregullave dhe Procedurat e PZAP-it Nr.02/2015 ku theksohet se: “Ankesat duhet të dorëzohen me shkrim dhe duhet të jenë të nënshkruara nga ankuesi apo në emër të tij nga i autorizuari”.

Prandaj Paneli, nuk u lëshua fare në meritat e ankesës, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozita e lartëtheksuara.

Nga arsyet e sipërhënuar e në mbështetje të nenit 5.6 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr.309/2019 më datën 06.10.2019.

**Kryesuesi i Panelit**  
Adrian Kopushevcj



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.